




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

### Zyra për Informim

Data/Date:	03.06.2024
Nga/Od/From	Komisioni për hartimin e draftit fillestar të Statutit të QKMF-së Kryesuesi i Komisionit, Besnik Smakaj
Për/Za/To:	z.Fadil Nura, Kryetar i Komunës
CC	Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, Adelina Spahiu
Tema/Subjekat/Subject	Raporti për ecurinë e hartimin e Draft-Statutit të QKMF-së

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me 12.03.2024, Kryetari i Komunës, Fadil Nura ka formuar komisionin për hartimin e draftit fillestar të Statutit të QKMF-së në këtë përbërje:

Besnik Smakaj, kryesues;

Emine Shabani Goxhuli, anëtare;

Herolinda Rukolli Pirraku, anëtare;

Lavdiqe Deliu, anëtare;

Ali Lutfiu, anëtar.

### Takimet

Me 22.03.2024, është mbajtur takimi i komisionit, i udhëhequr nga kryesuesi, Besnik Smakaj dhe në pjesëmarrje të të gjithë anëtarëve tjerë. U prezantua Draft-Statuti i cili ishte i punuar si formë unike nga Ministria e Shëndetësisë dhe i ishte dërguar Komunave. Në këtë takim anëtarët kanë diskutuar për rëndësinë e Draft-Statutit dhe pikat në të cilat parashihet të ndërhyhet. Komisioni u dakordua që ky Draft-Statut të dalë në konsultim publik nga data 24.04.2024 deri me datë 09.05.2024 kurse diskutimi publik të mbahet me datë 03.05.2024 në sallën e Kuvendit Komunal nga ora 11:00.

## **KONSULTIMI PUBLIK**

Konsultimi publik u hap më 24.04.2024 me dokumentin i cili u publikua në platforma të ndryshme si dhe duke njoftuar publikun për procesin e konsultimit publik për këtë Draft Statut dhe mundësinë e tyre për të dhënë komente.

### **Publikimi në web-faqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike**

Draft Statuti u publikua në këtë link në faqen zyrtare:  
<https://kk.rks-gov.net/.../04/Draft-Statuti-i-QKMF-se.docx>

Në Platformën e Konsultimeve Publike:  
<https://konsultimet.rks-gov.net/.../Draft-statuti-i-QKMF...>

## **KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË**

Më datë: 03.05.2024 mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, përfaqësues të OJQ-ve, qytetarë të ndryshëm. Dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Në ueb faqe:

<https://kk.rks-gov.net/skenderaj/news/drejtoria-per-shendetesi-e-mireqenie-sociale-ka-mbajtur-sot-diskutimin-publik-lidhur-me-draft-statutin-e-qkmf-se>

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

<https://kk.rks-gov.net/skenderaj/news/drejtoria-per-shendetesi-e-mireqenie-sociale-ka-mbajtur-sot-diskutimin-publik-lidhur-me-draft-statutin-e-qkmf-se/>

Konsultimi publik filloi në orën 11:00.

Konsultimin e shpalli të hapur Rrezarta Hasani Ibrahim – Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Arsyefimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
<p>1. Të lihet mundësia që për zgjedhjen e drejtorit të QKMF-së, në mungesë të mjekut familjar të zgjidhet edhe kandidati nga fusha tjetër</p> <p>2. Në vendet tjera ekziston menaxhmenti shëndetësor, pse nuk është e mundshme kjo edhe tek ne.</p> <p>3. Kemi nevojë për aftësi profesionale sepse kemi mungesë stafi në disa fusha. A mund të përfshihet kjo në statut?</p>	<p>1. Ashtu edhe është vepruar në draftin fillestar, për të mos mbetur peng i këtij kriteri zgjidhja e drejtorit.</p> <p>2. Ne do t'i bëjmë ndryshimet konform ligjit dhe vetëm për aq sa na lejon ligji.</p> <p>3. Të gjitha rekomandimet do të përfshihen në statut për aq sa lejon ligji.</p>

Komentet – Janë dhënë gjithsej 3 komente dhe të triat janë pjesë e draft-Planit

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet	1.Njoftimi 2.Lajmi 3.Procesverbali
Draft-Statuti i QKMF-së	Zyra për Informim Zyra e Kuvendit	F M T 18 7 25	Salla e Kuvendit 03.05.2024	3 komente Të 3 komentet janë marrë për bazë	1. <a href="https://kk.rks-gov.net/.../04/Draft-Statuti-i-QKMF-se.docx">https://kk.rks-gov.net/.../04/Draft-Statuti-i-QKMF-se.docx</a>  2. <a href="https://konsultimet.rks-gov.net/.../Draft-statuti-i-QKMF...">https://konsultimet.rks-gov.net/.../Draft-statuti-i-QKMF...</a>  3. <a href="https://kk.rksgov.net/skenderaj/news/drejtoria-per-shendetesi-e-mireqenie-sociale-ka-mbajtur-sot-diskutimin-publik-lidhur-me-draft-statutin-e-qkmf-s">https://kk.rksgov.net/skenderaj/news/drejtoria-per-shendetesi-e-mireqenie-sociale-ka-mbajtur-sot-diskutimin-publik-lidhur-me-draft-statutin-e-qkmf-s</a>

Ashtu siç është bërë edhe njoftimi publik për qytetarët, të njëjtit kanë pasur mundësi që komentet, vërejtjet apo sugjerimet e ndryshme t'i japin edhe në mënyrë elektronike tek emailat e zyrtarëve. Mirëpo asnjë koment nuk është pranuar në mënyrë elektronike për këtë Draft-Statut.

Kryesuesi i komisionit Besnik Smakaj ka thënë që të gjitha komentet që janë dhënë gjatë fazës së konsultimit publik, dhe që janë lejuar me ligj, janë përfshirë në Draft-Plan dhe janë pjesë e tij. Meqë faza e konsultimit publik ka përfunduar, atëherë unë në emër të këtij komisioni një raport mbi procesin e konsultimit publik do të ia dërgoj Kryetarit të Komunës dhe ky Draft-Statut do të dërgohet shpejt për miratim në Kuvendin Komunal.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

Vendimi për caktimin e grupit punues për hartimin e planit

Njoftimin publik për konsultimin publik

Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik

Listat e nënshkrimeve të anëtarëve në takimet e mbajtura

Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik